nëpërmjet shkresës nr. 1292/2, datë 13.11.2018, së Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

D. Në datën 19.11.2018, ankuesi dërgoi me e-mail në adresë të Komisionerit, kërkesën për tërheqje të ankesës së tij kundër Albpetrol sh.a., duke u shprehur se falë ndërhyrjes së Komisionerit, ai arriti të përfitonte pagesë, nga ana e shoqërisë, deri në momentin e daljes në pension. Në këtë kontekst, ai e konsideronte çështjen e zgjidhur dhe kërkonte përfundimin e proçedurës së shqyrtimit të ankesës së depozituar nga ana e tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 17 dhe nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Përfundimin e proçedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 149, datë 19.09.2018, së Z. P.H., pasi ky i fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës së tij.

2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha-punesim
Shkak – mosha dhe gjendja ekonomike

Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë , Tel: +355 4 2431078, Fax: +355 4 2431077, E-mail: info@kmd.al, web: www.kmd.al